

VENDIM
Nr. 708, datë 4.11.2022

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 425, DATË 27.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË SUBJEKTEVE TË PAJISURA ME LICENCË PËR PROJEKTIM, ZBATIM, MBIKËQYRJJE DHE KOLAUDIM NË PASURITË KULTURORE, PËR KRYERJEN E INVESTIMEVE ME FONDE PUBLIKE NË PASURITË KULTURORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 90, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 425, datë 27.5.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun II bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 1, pas fjalëve "... (në vijim "Komisioni") ..." shtohen "... i cili përbëhet nga Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Konkurrimit Publik dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ...".

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Procedurat e konkurrimit publik kryhen nga Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Konkurrimit Publik (në vijim "NJHDKP") dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave."

c) Pika 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"13. Njoftimi për konkurrim publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen elektronike të institucionit/autoritetit kontraktor që zhvillon procedurën, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara dorëzimit të ofertave për procedurat me fond limit mbi 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë, ndërsa për procedurat me fond limit, deri në 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë, njoftimi publikohet të paktën 8 (tetë) ditë para."

ç) Shkronja "P", e pikës 14, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"f) të ketë përvojë të mëparshme deri në 50% të vlerës së projektit të miratuar nga KKTKM-ja në kryerjen e ndërhyrjeve ruajtëse të projektimit, të mbikëqyrjes dhe të kolaudit në pasuritë kulturore;"

d) Pas pikës 14 shtohet pika 14/1, me këtë përmbajtje:

"14/1 Kriteret e përcaktuara në shkronjat "a", "b", "c", "d" dhe "dh" plotësohen me vetëdeklarim të ofertuesit. Fituesi i procedurës së konkurrimit publik dorëzon dokumentacionin origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin para lidhjes së kontratës."

dh) Pas pikës 18 shtohet pika 18/1, me këtë përmbajtje:

"18/1. NJHDKP-ja, në çdo kohë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara mbarimit të afatit të paraqitjes së ofertave, me iniciativën e saj ose në përgjigje të një kërkesë nga një subjekt i interesuar, mund t'i ndryshojë dokumentet e konkurrimit, duke e dokumentuar këtë ndryshim me 1 shtojcë, e cila bëhet pjesë e dokumentacionit të konkurrimit dhe u njoftohet subjekteve. Nëse NJHDKP-ja e konstaton të nevojshme të ndryshojë dokumentet e konkurrimit dhe kjo ndodh më vonë se 5 (pesë) ditë përpara mbarimit të afatit të fundit për paraqitjen e ofertave, mund të vendosë të shtyjë datën e zhvillimit të konkurrimit publik, me jo më shumë se 5 (pesë) ditë nga data e publikuar në fillim. Shtojcat publikohen në faqen elektronike të autoritetit kontraktor dhe Buletinin e Njoftimeve Publike."

e) Pika 23 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"23. Komisioni e Vlerësimit të Ofertave shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e hapjes së ofertave. Për procedurat e

konkurrimin publik, deri në 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë, dokumentacioni i paraqitur nga ofertuesit shqyrtohet brenda 7 (shtatë) ditëve nga NJVO-ja. Procesi i vlerësimit dokumentohet në një procesverbal dhe nënshkruhet nga anëtarët. Pas përfundimit të shqyrtimit, titullari i institucionit që zhvillon procedurën njofton në formë shkresore dhe me postë elektronike ofertuesit pjesëmarrës për renditjen dhe vlerësimin e secilit prej tyre.”.

ë) Pas pikës 23/1 shtohet pika 23/2, me këtë përmbajtje:

“23/2. Për procedurat e konkurrimin publik për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara në mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve në pasuritë kulturore dhe fondi limit i përlogaritur nuk i kalon 100 000 (njëqind mijë) lekë, përzgjedhja e subjekteve bëhet me tri oferta, pa procedurë, nga një komision i përbërë nga tre anëtarë.”.

2. Në kreun IV, pas pikës 2 shtohen pikat 2/1 dhe 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/1. Modifikimi i kontratës, pa zhvilluar një procedurë të re konkurrimi, gjatë afatit të zbatimit të saj, kryhet kur është bërë i nevojshëm, për shkak të rrethanave të paparashikuara nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike të konkurrimin. Modifikimi i kontratës kryhet për një kontratë që është ende në zbatim, për zëra që janë bërë të domosdoshëm për zbatimin e saj. Nga autoriteti kontraktor mund të bëhen disa modifikime të njëpasnjëshme me kusht që vlera e tyre të mos kalojë 25% të vlerës së kontratës. Arsyet dhe argumentimet për modifikimin e kontratës dokumentohen nga autoriteti kontraktor.

2/2. Autoriteti kontraktor cakton ndjekësin e kontratës, si person përgjegjës, i cili do të mbajë marrëdhëniet ndërmjet autoritetit kontraktor dhe kontraktorit.”.

3. Kudo në përmbajtjen e vendimit, fjalët “... njësia e vlerësimit të ofertave ...” zëvendësohen me emërtimin “Komisioni i Vlerësimit të Ofertave”.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore (DRTK) dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku